# "A BI ESSE " Sh.p.k.

Selia: Rruga 28 Nëntori Nr. 73, Kashar,Yrshek
Tiranë – Albania

## Pasqyrat Financiare për periudhën e mbyllur me 31 Dhjetor 2018

( me raportin e audituesit të pavarur ne vazhdim)

Tiranë më, 28 Mars 2019

**Përmbajtja**

1. Opinioni i Audituesit të Pavarur
2. Bilanci Kontabël
3. Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve
4. Pasqyra e flukseve monetare
5. Pasqyra e ndryshimeve në kapital
6. Shënime shpjeguese

# RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

**Për Ortakëve të Shoqërisë**
**"A BI ESSE" Shpk**
**Kapitali i regjistruar ne QKB-ne prej 450,000 mije leke**
**Komuna Kashar, Lagjja Yrshek, Rruga 28 Nëntori,**
**Tiranë - Shqipëri**

## Opinioni

Une kam audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë tregtare ***"A BI ESSE"***sh.p.k.,(shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2018, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur me daten 31 Dhjetor 2018, si edhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tim, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë tregtare ***"A BI ESSE"***sh.p.k.,me datën 31 Dhjetor 2018, dhe performancën financiare e flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK).

## Baza për Opinionin

Une e kreva auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të).Përgjegjësitë e mia sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Une jam e pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqiperi, dhe kam përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Une besoj se evidenca e auditimit që kam siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tim.

## Përgjegjësitë e Drejtimit dhe Organeve të Qeverisjes per Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare që japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë në përputhje me Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK),dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Drejtimi ka gjithashtu, përgjegjësine për të vlerësuar aftësinë e shoqërisë për të vazhduar veprimtarite në vijimësi, duke dhënë per kete qellim, kur eshte rasti, [illegible]
vijimësinë nisur nga parimi kontabël i vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi synon ta likujdojë shoqërinë, të ndërpresë aktivitetet e saj, ose rasteve kur drejtimi nuk ka alternativë tjetër reale përveç likujdimit te shoqerise.

Organet e ngarkuara me qeverisjen kane përgjegjësine për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

## Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona te auditimit janë: të arrijmë një siguri të arësyeshme per faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi kanë ose jo anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport, i cili perfshin opinionin e auditusit. Siguria e arsyeshme megjithese është një siguri e nivelit të lartë, nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, indiviualisht ose të marra së bashku pritet, që në mënyrë të arësyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Nje auditim i pasqyrave financiare në përputhje me SNA-të, kerkon qe ne si auditues te ushtrojmë gjykimin profesional dhe te ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Une gjithashtu:

- Identifikoj dhe vlerësoj rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku i anomalise materiale si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara ose anashkalime të kontrolleve të brendshme.

- Siguroj një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë.

- Vlerësoj përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.

- Nxjerr një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë dhe, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Kur arrij në përfundimin që ka një pasiguri une duhet të tërheq vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikoj opinionin tim. Konkluzionet e mia bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tim të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

- Une komunikoj me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që une mund të identifikoj gjatë auditimit.

**Audituesi ligjor**

**Eda ABAZI, (AL/CPA)**
**Partner Auditimi**
**Rruga e Barrikadave Ish Kinema 17 Nentori.**
**Tel: +355 42 227 695**
**Fax: +355 42 227 695**

Studio L.E.A.A. Auditing Sh.p.k.

**29 Mars 2019**

## Bilanci Kontabël për periudhën që mbyllet më 31.12.2018

| **AKTIVET** | **Shen** | **31.12.2018** | **31.12.2017** |
|---|---|---|---|
| **Aktivet Afatshkurtëra** | | | |
| **Aktive monetare** | 4 | **27,774,639** | **15,134,659** |
| **Aktive të tjera financiare afatshkurtra** | | | |
| *Llogari/Kërkesa të arkëtueshme* | 5.1 | 135,928,976 | 116,622,753 |
| *Llogari/Kërkesa të tjera të arkëtueshme* | 5.2 | 30,820,991 | 37,779,972 |
| **Totali** | | **166,749,968** | **154,402,725** |
| **Inventari** | | | |
| *Mallra për rishitje* | 6 | 463,924,536 | 426,228,738 |
| *Parapagesat për furnizime* | 6 | 3,909,680 | 6,478,595 |
| *Inventar i imet/Të tjera gjëndje inventari* | 6 | 1,109,482 | 914,232 |
| **Totali** | | **468,943,698** | **433,621,565** |
| **Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra** | 6.2 | 5,414,448 | 3,380,959 |
| **Total i Aktiveve Afatshkurtra (I)** | | **668,882,753** | **606,539,908** |
| **Aktivet afatgjata** | | | |
| **Investimet financiare afatgjata** | | - | - |
| **Aktive afatgjata materiale** | | | |
| *Toka* | 7 | 339,082,845 | 337,751,185 |
| *Ndërtesa* | 7 | 19,320,051 | 20,336,896 |
| *Makineri dhe pajisje* | 7 | 25,749,008 | 26,157,384 |
| *Aktive të tjera afatgjata materiale (me vl.kontab.)* | 7 | 16,479,429 | 14,904,120 |
| Aktive afatgjata materiale ne poces | 7 | 20,393,797 | 2,092,653 |
| **Totali** | | **421,025,131** | **401,242,239** |
| **Aktivet afatgjata jomateriale** | | | |
| Aktive të tjera afatgjata jomateriale/Liçenca | 7 | 728,297 | 892,682 |
| **Totali** | | **728,297** | **892,682** |
| **Totali i aktiveve Afatgjata (II)** | | **421,753,428** | **402,134,921** |
| **TOTALI I AKTIVEVE (I + II)** | | **1,090,636,181** | **1,008,674,829** |
| | | | |
| **DETYRIMET DHE KAPITALI** | | | |
| **DETYRIMET Afatshkurtëra** | | | |
| **Huamarrjet** | | | |
| Huat afatshkurtra - Overdrafte | 8.1 | 141,815,310 | 151,123,378 |
| Huamarrje afat-shkurtra | 8.1 | 22,785,238 | 26,804,773 |
| **Totali** | | **164,600,548** | **177,928,151** |
| **Huat dhe parapagimet** | | | |
| *Të pagueshme ndaj furnitorëve* | 8.2 | 168,054,554 | 156,423,123 |
| *Të pagueshme ndaj punonjësve* | | 2,283,449 | 0 |
| *Detyrime tatimore* | 8.3 | 14,643,568 | 2,853,941 |
| *Hua të tjera* | 8.4 | 2,655,205 | 2,828,231 |
| **Totali i detyr. afatshkurtra** | | **352,237,324** | **340,033,446** |
| **DETYRIME AFATGJATA** | | | |
| **Huat afatgjata** | | | |
| Huamarrje të tjera afatgjata | 9 | 39,114,627 | 66,679,525 |
| **Totali** | | **39,114,627** | **66,679,525** |
| **Provizionet afatgjata** | | **0** | **0** |
| **Totali i detyr. afatgjata** | | **39,114,627** | **66,679,525** |
| **Totali i detyrimeve** | | **391,351,950** | **406,712,971** |
| **Kapitali** | | | |
| Kapitali aksionar | 10 | 450,000,000 | 450,000,000 |
| Rezerva ligjore | 10 | 33,772,078 | 26,597,378 |
| Rezerva të tjera | 10 | 79,092,308 | 52,534,059 |
| Fitimet e pashpërndara | 10 | 0 | 0 |
| Fitimi (humbja) e vitit financiar | 10 | 136,269,844 | 72,680,421 |
| Të tjera (kapital i falur) | 10 | 150,000 | 150,000 |
| **Totali i kapitalit (III)** | | **699,284,230** | **601,961,858** |
| **TOTALI I DETYRIMEVE KAPITALIT** | | **1,090,636,180** | **1,008,674,829** |

A BI ESSE MATERIAL ELEKTRIK
Selia Qëndrore NIPT J61818010A
Rruga 28 Nëntori 73, K.P.1051, Kashar, Tiranë

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese pikat 1-14

## Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve për periudhën 1 janar deri 31 dhjetor 2018

| | | Viti 2018 | Viti 2017 |
|---|---|---|---|
| Shitjet neto | 11.1 | 1,147,577,169 | 997,384,793 |
| Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit | 11.2 | 31,608,546 | 28,510,476 |
| Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatëshme dhe prodhimit në proces | | - | - |
| Materialet e konsumuara | 11.3 | -842,041,280 | -786,476,462 |
| Kosto e punës | | | |
| -Pagat e personelit | 11.4 | -67,264,742 | -60,200,105 |
| -Shpenzimet per sigurimet shoqerore dhe shendetësore | 11.4 | -9,616,175 | -8,885,581 |
| Amortizimi dhe zhvleresimet | 7 | -11,000,682 | -10,473,400 |
| Shpenzime të tjera | 11.5 | -111,885,771 | -72,445,740 |
| **Totali i shpenzimeve** | | **-1,041,808,649** | **-938,481,288** |
| **Fitmi apo humbja nga veprimtaria kryesore** | | **137,377,066** | **87,413,982** |
| Të ardhurat dhe shpenzimet financiare: | | | |
| Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi | 11.6 | -5,426,883 | -5,544,052 |
| Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi | 11.7 | 29,301,902 | 4,508,367 |
| Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare | | - | - |
| **Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare** | | **23,875,019** | **-1,035,685** |
| ***Fitimi (humbja) para tatimit*** | | **161,252,085** | **86,378,296** |
| Shpenzimet e tatimit aktual mbi fitimin | 12 | -24,982,241 | -13,697,875 |
| **Fitmi (humbja) neto e vitit financiar** | | **136,269,844** | **72,680,421** |

| | | |
|---|---|---|
| **Të Ardhura të Tjera gjithpërfshirëse** | | |
| Fitimi (Humbje) nga rivlerësimi i AAM | - | - |
| Fitimi (Humbje) nga rivlerësimi i AAFinacniare | - | - |
| **Totai i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse neto nga tatimet** | | |
| **Totali i të ardhurave neto gjithpërfshirëse për periudhën** | 136,269,844 | 72,680,421 |

*Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese pikat 1-14*

Pasqyrat Financiare të shoqërisë A BI ESSE Sh.p.k. janë përgatitur nga Drejtimi i Shoqërisë më
28 Mars 2019

| | |
|---|---|
| **JONIDA HOXHA** | **RAF PILIKA** |
| Përgjegjës i Kontabilitetit | Administrator |

A BI ESSE
MATERIAL ELEKTRIK
Selia Qëndrore NIPT J61818010A
Rruga 28 Nëntori 73, K.P.1051, Kashar, Tiranë

## Pasqyra e flukseve monetare për periudhën 1 janar deri 31 dhjetor 2018

| **Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit** | **2018** | **2017** |
|---|---|---|
| Fitim / Humbja e vitit | 136,269,844 | 72,680,421 |
| Rregullimet për shpenzimet jomonetare: | | |
| Shpenzimet financiare jomonetare | | |
| Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar | - | - |
| Shpenzime konsumi dhe amortizimi | 11,000,682 | 10,473,400 |
| Diferenca kursi kembimi | - | - |
| Shpenzime të llogaritura per interesat | - | - |
| Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit: | | |
| Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera | -12,347,242 | 93,997,743 |
| Rënie/(rritje) në inventarë | -35,322,133 | -77,612,579 |
| Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme | 11,631,431 | 35,153,434 |
| Rritje/(rënie) në detyrime per punonjesit | 2,283,449 | - |
| Rritje/(rënie) në shpenzimet e shtyra | -2,033,489 | -3,141,418 |
| Rritje/(rënie) në parapagimet e arketuara e te tjera | -173,026 | -2,128,760 |
| Rritje/(rënie) në detyrimet tatimore | 11,789,627 | -359,563 |
| Rritje/(rënie) në Hua dhe Obligacione Afatshkurtra | -13,327,603 | -35,635,797 |
| **Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit** | **109,771,539** | **93,426,881** |
| | | |
| **Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit** | | |
| Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale | -48,688,863 | -15,141,421 |
| Arkëtime nga shitja / nxjerrja jashte perdorimit e aktiveve afatgjata materiale | 18,069,674 | 1,943,810 |
| **Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit** | **-30,619,189** | **-13,197,612** |
| | | |
| **Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit** | | |
| Hua bankare e te tjera | -27,564,898 | -42,401,119 |
| Dividendë të paguar | -38,947,472 | -28,325,434 |
| **Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit** | **-66,512,370** | **-70,726,553** |
| | | |
| **Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare** | **12,639,980** | **9,502,716** |
| **Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar** | **15,134,659** | **5,631,943** |
| **Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor** | **27,774,639** | **15,134,659** |

*Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese pikat 1-14*

## Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital për periudhen 1 janar deri më 31 dhjetor 2018

| | Kapitali aksionar | Rezerva statusore dhe ligjore | Fitimi i pashpërndarë | Rezerva të tjera | Kapitali i falur | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Pozicioni më 31 dhjetor 2016** | **450,000,000** | **26,597,378** | **70,813,585** | **10,045,908** | **150,000** | **557,606,871** |
| Efekti i ndrysh. në politikat kontabël | | | | | | |
| **Pozicioni i rregulluar** | **450,000,000** | **26,597,378** | **70,813,585** | **10,045,908** | **150,000** | **557,606,871** |
| Fitimi neto i periudhës kontabël | | | 72,680,421 | | | **72,680,421** |
| Dividendët e paguar/*deklaruar* | | | -28,325,434 | | | **-28,325,434** |
| Transferime në rezervën e detyrueshme ligjore | | | | | | **-** |
| Transferime në rezervën e detyrueshme statutore | | | | 42,488,151 | | **42,488,151** |
| Transferime në rezerva të tjera | | | -42,488,151 | | | **-42,488,151** |
| Emetim i kapitalit aksionar | | | | | | **-** |
| **Pozicioni më 31 dhjetor 2017** | **450,000,000** | **26,597,378** | **72,680,421** | **52,534,059** | **150,000** | **601,961,858** |
| Efekti i ndrysh. në politikat kontabël | | | | | | |
| **Pozicioni i rregulluar** | **450,000,000** | **26,597,378** | **72,680,421** | **52,534,059** | **150,000** | **601,961,858** |
| Fitimi neto i periudhës kontabël | | | 136,269,844 | | | **136,269,844** |
| Dividendët e paguar/*deklaruar* | | | | -38,947,472 | | **-38,947,472** |
| Transferime në rezervën e detyrueshme ligjore | | | | | | **-** |
| Transferime në rezervën e detyrueshme statutore | | 7,174,700 | | 69,046,400 | | **76,221,100** |
| Transferime në rezerva të tjera | | | -72,680,421 | -3,540,679 | | **-76,221,100** |
| Emetim i kapitalit aksionar | | | | | | **-** |
| **Pozicioni më 31 dhjetor 2018** | **450,000,000** | **33,772,078** | **136,269,844** | **79,092,308** | **150,000** | **699,284,230** |

*Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese pikat 1-14*

# 1. Të përgjithshme

Shoqëria A BI ESSE Sh.p.k. është shoqëri e së drejtës shqiptare me kapital të përbashkët me investitor të huaj. Ajo është regjistruar me vendimin e gjykatës së Rrethit Tiranë Nr.11918 datë 24/08/1995. Objekti kryesor i veprimtarisë së saj është Import-Eksporti dhe tregtimi i artikujve dhe pajisjeve elektrike dhe materialeve të tjera tregtare.

Struktura e kapitalit të shoqëris më 31 Dhjetor 2018 paraqitet si vijon.

| Ortaket | Perqindja e zoterimit | Shuma e kapitalit ne leke |
|---|---|---|
| Raf PILIKA | 47.5% | 213,750,000 |
| Ret PILIKA | 47.5% | 213,750,000 |
| Giuseppe SARVIA | 5% | 22,500,000 |
| **Totali** | **100%** | **450,000,000** |

Numri i përgjithshëm i kuotave është 1,000

Administrator i shoqërisë gjatë vitit 2018 ka qenë Z.Raf Pilika.

*Adresa e shoqërisë*: Rruga. 28 Nëntori Nr.73, Kashar,Yrshek – Tiranë.
Shoqëria është e regjistruar si person juridik në Degën e Tatimpaguesve të Mëdhenj me NIPT: J61818010A.
Më 31 Dhjetor 2018 shoqëria ka 67 punonjës (31 Dhjetor 2017, 63 punonjës).

# 2. Parimet e përgatitjes së Pasqyrave Financiare

## (a) Deklarata e parimeve kontabël

Shoqëria mban regjistrimet kontabël dhe përgatit pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin kontabël në Shqipëri.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Ligjin nr. 9228 date 29 Prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar dhe Standardet Kombëtare te Kontabilitetit (SKK) të përmirësuara të publikuara bazuar ne urdhrin e Ministrit të Financave nr 64 datë 22.07.2014 "Për Shpalljen e Standardeve Kontabël Kombëtare të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre". **(b)**

## Parimet e Përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike.
Politikat kontabël janë zbatuar në përputhje me kërkesat e SKK-ve të përmirësuara dhe të ligjit nr. 9228 date 29 Prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe paraqiten në shënimin vijues.

# 3. Politikat Kontabël më kryesore

Një përmbledhje të pjesës më të madhe të Politikave Kontabël mbi bazën e të cilave janë përgatitur Pasqyrat Financiare janë paraqitur sa më poshtë.

### *3.1 Njohja e të Ardhurave dhe Shpenzimeve*

Në lidhje me shitjen e mallrave, të Ardhurat janë njohur në Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve atëherë kur ndryshimi i pronësisë së bashku me riskun që vjen nga ky ndryshim, janë transferuar tek bleresi dhe kur shoqëria do të ketë të mundur të marrë përfitime ekonomike të cilat mund të vlerësohen me siguri. Shpenzimet janë njohur në Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria ka zbatuar parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtës periudhë.

### *3.2 Shpenzime për personelin*

*(i) Kontributet për Sigurime Shoqërore dhe të ngjashme*

Shoqëria, gjatë aktivitetit të saj normal, kryen pagesa në emer të saj dhe të punonjësve të saj për kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në pajtim me legjislacionin në fuqi. Shpenzimet përkatëse të bëra në emër të Shoqërisë ngarkohen në Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve me ndodhjen e tyre.

### *3.3 Aktivet Afatgjata Materiale (AAM)*

*(i) Njohja dhe Vlerësimi*

AAM vlerësohen në hyrje me kosto historike. AAM paraqiten në Bilanc me koston e amortizuar (koston historike minus amortizimin e akumuluar). Kosto historike përfshin shpenzimet që i përkasin direkt blerjes së elementëve. Kostot e kryera më vonë përfshihen në vlerën e mbartur të aktivit ose njihen si një aktiv më vehte, sipas rastit, vetëm nëse është e mundshme që ky element të sjellë hyrje të përfitimeve të ardhshme ekonomike në shoqëri dhe kostoja e këtij elementi të mund të matet me besueshmëri. Të gjitha shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit regjistrohen si shpenzime në periudhën që ato kryhen dhe paraqiten në zërin e shpenzimeve operative.

*(ii) Amortizimi*

Amortizimi i ndërtesave llogaritet dhe njihet në Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve me metodën e vlerës së mbetur (ligji Nr.10228 datë.04.02.2010). Po kështu edhe për të gjithë zërat e tjerë, Amortizimi llogaritet dhe njihet me metodën e vlerës së mbetur, me norma të cilat janë të përafërta me jetëgjatësinë mesatare të parashikuar të përdorimit.
Normat e amortizimit të përdorura janë të paraqitura si më poshtë:

| | **Norma Amortizimit %** | **Metoda Llogaritjes** |
|---|---|---|
| Ndërtesa | 5 | Me Vlerën e mbetur |
| Makineri e pajisje | 20 | Me Vlerën e mbetur |
| Mjete Transporti | 20 | Me Vlerën e mbetur |
| Mobilje Orendi e të Tjera | 20 | Me Vlerën e mbetur |
| Pajisje Informatike | 25 | Me Vlerën e mbetur |

### *3.4 Transaksionet me Monedhat e huaja*

Transaksionet në monedha të huaja të kryera gjatë vitit janë konvertuar në lek me kursin e këmbimit të vendosur në datën e transaksionit. Elementët monetarë në monedhë të huaj janë konvertuar në lek me kursin e fund vitit, i cili paraqitet:

| 31 Dhjetor 2018 | 31 Dhjetor 2017 |
|---|---|
| 1 Euro = 123.42 Lek | 1 Euro = 132.95 Lek |
| 1 Usd = 107.82 Lek | 1 Usd = 111.10 Lek |

Diferencat e konvertimit në Lek të gjëndjeve monetare në valutë të huaj janë kaluar në rezultat. Shoqëria ka bërë konvertimin në Lek në fund të vitit të të drejtave dhe detyrimeve në valutë të huaj. Diferencat nga ky konvertim jane sistemuar në llogaritë e Bilancit Kontabël (në rezultatin e periudhës), në përputhje me kërkesat e SKK 12 "Efekti i Ndryshimit të Kurseve të Këmbimit".

### *3.5 Kërkesa për Arkëtim dhe Detyrimet Tregtare*

Kërkesat për arkëtim janë paraqitur me vlerën e kostos së tyre. Detyrimet ndaj furnitorëve janë paraqitur me shumën e faturës së marrë prej tyre. Detyrimet ndaj Institucioneve Shtetërore janë paraqitur me shumën e tyre të llogaritur sipas kërkesave ligjore. Vlera e humbjeve nga klientët apo debitorët paraqitet si shpenzim kur ata klasifikohen si të dyshimtë, të humbur apo pa shpresë për arkëtim. Për vitin 2018 nuk është krijuar provizion për borxhin e keq.

### *3.6 Tatimi mbi fitimin*

Tatimi mbi fitimin është llogaritur në përputhje me kërkesat e ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat" duke bërë rregullimet e fitimit kontabël me Shpenzimet e panjohura dhe të Ardhurat e patatueshme. Shoqëria llogarit dhe njeh tatimin aktual. Për vitin ushtrimor shoqëria nuk ka llogaritur dhe njohur tatim të shtyrë mbi fitimin.

## 4. Aktive Monetare

Mjetet Monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë Mjete Monetare në Arkë dhe ato të mbajtura në bankë. Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në Pasqyrat e Fluksit të Mjeteve Monetare përfshin Mjetet Monetare (arkëtimet në MM dhe depozitat me afat) dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare (investimet afat-shkurtra, nëse ka, të cilat janë shumë likuide dhe menjëherë të konvertueshme në një vlerë që njihet me siguri dhe vlera e të cilave ndryshon shumë pak). Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrën e fluksit të Mjeteve Monetare nuk përfshin investimet në letrat me vlerë të listuara, investimet me një datë maturimi fillestare afati i të cilës është mbi tre muaj dhe pa një klauzolë përfundimi më të hershëm të këtij afati, ose llogaritë bankare që kanë kufizime në përdorim, kufizime këto të ndryshme nga ato të cilat janë si pasojë e rregullimeve specifike në një shtet ose sektorë të aktiviteteve (kontrollet e këmbimit, etj).

Mjetet Monetare përbëhen si vijon:

| Pershkrimi I Llogarive | 2018 | 2017 |
|---|---|---|
| Mjete monetare në banke | 17,221,382 | 9,695,204 |
| Mjete monetare në arkë | 10,553,257 | 5,439,455 |
| **Total** | **27,774,639** | **15,134,659** |

### 4.1 Mjetet Monetare në Arke

Gjëndja e Mjeteve Monetare në Arkë paraqitet si vijon:

| Pershkrimi I Llogarive | | 31 Dhjetor 18 | 31 Dhjetor 17 |
|---|---|---|---|
| | Arka ne lek | 10,202,407 | 5,252,768 |
| | Arka ne euro | 350,850 | 186,687 |
| **Total** | | **10,553,257** | **5,439,455** |

Gjëndja e Mjeteve Monetare të shprehura në monedhë të huaj është konvertuar me kursin e datës 31.12.2018 të shpallur nga Banka e Shqipërisë.

### 4.2 Mjetet Monetare në Llogaritë Bankare.

Konvertimi i gjëndjes në monedhë të huaj është bërë me kursin e datës 30.12.2018 të shpallur nga Banka e Shqipërisë. Diferencat e rezultuara nga rivlerësimi i likuiditeteve në monedhë të huaj janë sistemuar në rezultatin e periudhës.

Përbërja e llogarisë "Banka" sipas gjëndjes të shprehura në lek paraqitet si vijon:

| Pershkrimi I Llogarive | 31 Dhjetor 18 | 31 Dhjetor 17 |
|---|---|---|
| Llogari Rrjedhese prane Bankave | 11,348,083 | 2,948,575 |
| Llogari Rrjedhese prane Bankave | 5,873,299 | 6,746,629 |
| | - | |
| **Total** | **17,221,382** | **9,695,204** |

### 5. Aktive Të Tjera Financiare Afatshkurtra

Aktive të Tjera Financiare Afatshkurtra më datë 31 Dhjetor 2018 paraqiten në Bilanc me vlerën e tyre të arkëtueshme. Përbërja e tyre jepet në vijim:

| Aktive të tjera financiare afatshkurtra | | Viti 2018 | Viti 2017 |
|---|---|---|---|
| | Kërkesa të arkëtueshme | 135,928,976 | 116,622,753 |
| | Kërkesa të tjera nga të tretët | 19,408,544 | 37,779,972 |
| **TOTALI** | | **155,337,521** | **154,402,725** |

## 5.1 Kërkesa Të Arkëtueshme

Kërkesa Të Arkëtueshme paraqesin shumat e faturuara klientëve për mallrat e shitura me arkëtim të mëvonshëm. Paraqitja e tyre është si vijon:

| Pershkrimi I Llogarive | | 2018 | 2017 |
|---|---|---|---|
| | Kliente lek | 129,580,087 | 101,683,430 |
| | Kliente Euro | 6,348,889 | 14,939,323 |
| Total | | 135,928,976 | 116,622,753 |

Ndër klientët kryesorë të shoqërisë për vitin 2018 janë: Tirana International Development Shpk, K Bi Esse, Alvision shpk, Haki Sinani shpk, Fishta Electric shpk, Alba konstruksion shpk, A & GI shpk, Interlogistic shpk, American Millennium Investors, Kaexh shpk etj.

## 5.2 Kërkesa Të Tjera nga Të Tretët

Në këtë zë të Bilancit paraqiten kërkesat ndaj të tretëve që nuk lidhen me shitjet si dhe kërkesat ndaj Institucioneve Shtetërore për tatime e taksa.

Në tabelën vijuese jepet një paraqitje e perbërjes së tyre:

| Pershkrimi I Llogarive | | 2018 | 2017 |
|---|---|---|---|
| | Parapagime Tatim Fitimi | - | 1,232,079 |
| | Shteti TVSH e zbritshme | 1,200,991 | 8,234,670 |
| | Te tjera | 29,620,001 | 28,313,224 |
| Total | | 30,820,991 | 37,779,973 |

## 6. Inventarët

Shoqëria i njeh Inventarët e mallrave dhe materialeve kur merr përsipër riskun dhe përfitimet nga to, pavarësisht nëse i ka paguar apo jo. Në hyrje Inventarët vlerësohen me koston e cila përfshin cmimin e blerjes, taksat dhe shpenzimet e transportit. Gjëndja e Inventarit në fund të vitit vlerësohet me më të voglën midis kostos së blerjes dhe Vlerës Neto të Realizueshme VNR. Sipas drejtimit të Shoqërisë kostoja është më e vogël se Vlera Neto e Realizueshme prandaj Inventarët janë paraqitur në Bilanc me koston e tyre. Përdor metodën kontabël të inventarizimit periodik.

Inventarët paraqesin gjëndjen e mallrave në magazinë dhe në pikat e shitjes të Shoqërisë si dhe të Inventarit të imët dhe lëndë djegëse (karburant) gjëndje sipas pasqyrës vijuese. Inventarët vlerësohen me koston sipas FIFO.

| Pershkrimi | | 2018 | 2017 |
|---|---|---|---|
| | Te tjera gjendje inventari - inventar i imet | 1,109,482 | 914,232 |
| | Mallra per rishitje | 463,924,536 | 426,228,738 |
| | Parapagime per furnizime | 3,909,680 | 6,478,595 |
| Total | | 468,943,698 | 433,621,565 |

## 6.1 Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Në këtë zë paraqiten shpenzimet e parapaguara, kryesisht për qiranë pqr njq nga ambjentet e saj, të cilën shoqëria e ka parapaguar deri në vitin 2020.

| Pershkrimi | 2018 | 2017 |
|---|---|---|
| Shpenzime te periudhave te ardhme | 5,414,448 | 3,380,959 |
| **Total** | **5,414,448** | **3,380,959** |

## 7. Aktivet Afatgjata Materiale dhe Jo-Materiale

Në vijim paraqiten pasqyrat në lidhje me lëvizjet e AAM-ve gjatë vitit 2018 si dhe amortizimet përkatëse.

**PASQYRA E LEVIZJES SË AAM DHE AAJM PËR PËR VITIN 2018**

| AKTIVE AFATGJATA MATERIALE | Gjendje në çelje të ushtrimit | Shtesa gjatë 2018 nga blerjet | Riklasifikimi gjatë 2018 | Daljet gjatë 2018 | Gjëndja më 31.12.2018 |
|---|---|---|---|---|---|
| Licenca | 1,275,260 | 27,245 | | - | 1,302,505 |
| Toka | 337,751,184 | 1,331,660 | | - | 339,082,844 |
| Ndërtime, instalime të përgj. | 31,314,906 | - | | - | 31,314,906 |
| Insta.teknike,makineri, pajisje | 28,604,977 | 76,392 | | 29,059 | 28,652,310 |
| Mjete transporti | 57,635,306 | 11,844,473 | | 17,047,579 | 52,432,199 |
| Paisje zyre e orendi | 17,938,008 | 4,345,600 | | 1,740,080 | 20,543,528 |
| Paisje informatike | 17,406,098 | 2,834,835 | | - | 20,240,933 |
| Të tjera AAM | 18,225,779 | 159,353 | | - | 18,385,132 |
| AAM ne Proces | 2,092,653 | 28,069,305 | | 9,768,160 | 20,393,797 |
| **TOTALI** | **512,244,171** | **48,688,863** | | **28,584,878** | **532,348,155** |

**PASQYRA E LLOGARITJES SË AMORTIZIMEVE TË AAM DHE AAJM PËR VITIN 2018**

| AMORTIZIMI I AKTIVEVE AFATGJATA | Në çelje të ushtrimit | Shtesat Amortizimi vjetor | Riklasifikimi gjatë 2018 | Pakësime | Shuma në mbyllje të ushtrimit |
|---|---|---|---|---|---|
| Licenca | 382,578 | 191,630 | | - | 574,208 |
| Ndërtime, instalime të përgj. | 10,978,001 | 1,016,845 | | - | 11,994,846 |
| Instalime teknike,makine,pajisje | 23,738,586 | 1,104,226 | | - | 24,842,812 |
| Mjete transporti | 36,344,305 | 4,663,581 | | 10,515,204 | 30,492,682 |
| Paisje zyre e orendi | 11,998,862 | 1,517,082 | | - | 13,515,944 |
| Paisje informatike | 12,284,830 | 1,733,367 | | - | 14,018,197 |
| Të tjera AAM | 14,382,076 | 773,951 | | - | 15,156,027 |
| **TOTALI** | **110,109,250** | **11,000,682** | | **10,515,204** | **110,594,728** |
| | | | | | |
| **VKN 31.12.2018** | **402,134,921** | | | | **421,753,428** |

## 7 Aktivet Afatgjata Materiale dhe Jo-Materiale-vazhdim

Llogaritja e Amortizimit të AAM dhe AAJM është bërë duke marrë parasysh kohën e hyrjes së Aktiveve. Normat e Amortizimit të përdorura janë në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.8438 datë 28.12.1998, "Për Tatimin Mbi Të Ardhurat". Këto norma marrin parasysh përafërsisht edhe jetëgjatësinë e përdorimit të këtyre aktiveve nga shoqëria. *Shoqëria nuk ka ndryshuar politikat kontabël në lidhje me Aktivet Afatgjata në raport me vitin e kaluar.*
Në bilanc Aktivet Afatgjata Materiale dhe Jo-Materiale paraqiten për çdo grup me vlerën neto te tyre. Referojuni gjithashtu pasqyrave të dhëna më lart në këtë shënim.

## 8. Detyrimet Afatshkurtra

Paraqitja e tyre në Bilancin kontabël jepet në tabelën vijuese:

| DETYRIMET AFATSHKURTRA | Viti 2018 | Viti 2017 |
|---|---|---|
| Hua dhe Obligacione Afatshkurtra | 164,600,548 | 177,928,151 |
| Të Pagueshme ndaj Furnitorëve | 168,054,554 | 156,423,123 |
| Të pagueshme ndaj punonjësve | 2,283,449 | |
| Detyrime Tatimore | 3,231,121 | 2,853,941 |
| Të tjerë kreditorë | 2,655,205 | 2,828,231 |
| **TOTALI** | **352,237,324** | **340,033,446** |

### *8.1 Hua dhe Obligacione Afatshkurtra*

Paraqet tepricën e llogarisë së huave (overdraft / linjë kredie) të marra gjëndje në 31.12.2018. Paraqitja si vijon:

| Pershkrimi | 2018 | 2017 |
|---|---|---|
| Huat afatshkurtra - Overdrafte | 141,815,310 | 151,123,378 |
| Huamarrje afat-shkurtra - Kesti 12 mujor | 22,785,238 | 24,544,623 |
| Hua afat-shkurter nga ortaku | 0 | 2,260,150 |
| **Total** | **164,600,548** | **177,928,151** |

### *8.2 Të Pagueshme ndaj Furnitorëve*

Detyrimet ndaj Furnitorëve janë paraqitur në bilanc për shuma që do të paguhen pas datës 31.12.2018. Një paraqitje analitike e tyre jepet në tabelën vijuese:

| Pershkrimi | 2018 | 2017 |
|---|---|---|
| Furnitore ne leke | 19,552,562 | 4,300,544 |
| Furnitore ne Euro | 148,501,992 | 152,122,579 |
| **Total** | **168,054,554** | **156,423,123** |

Ndër Furnitorët kryesorë që shoqëria vepron për tregtimin e artikujve elektrikë mund të përmendim I.C.E.L S.C.P.A., BI ESSE S.P.A., SCHNEIDER ELECTRIC BULGARIA EOOD, URMET S.P.A., LEGRAND, PROSPECTA S.R.L CAVI SPECIALI, ZAMET S.P.A., IMET S.R.L. etj.

### *8.3 Detyrime Tatimore*

Detyrimet Tatimore përbëhen nga detyrimet ndaj Institucioneve Shtetërore për Tatime e Taksa si dhe nga detyrimet për kontributet e detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore e Shëndetsore. Këto detyrime paraqiten si vijon:

| Pershkrimi | 2018 | 2017 |
|---|---|---|
| Shteti Sigurimet Shoqerore e Shendetsore | 1,762,433 | 1,602,493 |
| Shteti Tatim Mbi te Ardhurat Personale | 890,677 | 736,285 |
| Detyrim Tatim ne burim | 578,011 | 515,163 |
| Tatim fitimi | 11,412,447 | - |
| **Total** | **14,643,568** | **2,853,941** |

### *8.4 Të Tjerë Kreditorë*

Zëri "Kreditorë të tjerë" për vitin 2018 paraqitet si vijon:

| Pershkrimi | 2018 | 2017 |
|---|---|---|
| Te ardhura te paperfituara | 1,959,930 | 1,959,930 |
| Detyrime te tjera | 635,550 | 868,300 |
| Dividente per tu paguar | 59,725 | - |
| **Total** | **2,655,205** | **2,828,230** |

Zëri "Të ardhura të papërfituara" për shumën 1,960 mijë lek paraqet shumën e marrë nga kompensimin e shtetëzimit të një pjese të Tokës në emër të Drejtorisë së Rrugëve për të cilën ende nuk është bërë regjistrimi në emër të kësaj Drejtorie.

Zëri "Të tjera detyrime", përfaqësojnë detyrimet ndaj ortakëve për interesat e maturuara më 31.12.2018 ne lek lidhur me huatë afatgjata të marra prej ortakëve të Shoqërisë ( referojuni pasqyrës të pikës 9 ).

## 9. Detyrimet Afatgjata

Paraqet huatë afatgjata marrë nga dy prej ortakëve të Shoqërisë si dhe tepricën e llogarisë së huasë afatgjatë marrë nga ABI Bank. Perberja analitke e tij paraqitet si më poshtë:

| Pershkrimi | 2018 | 2017 |
|---|---|---|
| Huamarrje nga ortaket | 29,620,800 | 31,908,000 |
| Huamarrje bankare afatgjata-ABI Bank | 9,493,827 | 34,771,525 |
| **Total** | **39,114,627** | **66,679,525** |

## 10. Kapitalet e Veta

Përbërja dhe ndryshimi i kapitaleve të veta jepet në pasqyrën vijuese:

| Pershkrimi | 2018 | 2017 |
|---|---|---|
| Kapitali i paguar | 450,000,000 | 450,000,000 |
| Rezerva ligjore | 33,772,078 | 26,597,378 |
| Rezerva te tjera | 79,092,308 | 52,534,059 |
| Kapital i falur | 150,000 | 150,000 |
| Fitimi (Humbja) i/e vitit te kaluar | - | - |
| Fitimi (Humbja) i/e vitit financiar | 136,269,844 | 72,680,421 |
| **Total** | **699,284,230** | **601,961,858** |

## 11. Të Ardhurat dhe Shpenzimet

Për periudhën kontabël që mbyllet me 31 dhjetor 2018 shoqeria. ka kryer shpenzime dhe ka realizuar të ardhura në përputhje me aktivitetin e vet të cilat janë paraqitur në Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve të ndërtuar sipas natyrës.

### *11.1 Shitjet Neto*

Gjatë vitit 2018 Shoqëria ka realizuar të Ardhura kryesore që përbëjnë shifrën e afarizmit të saj, nga shitja e mallrave e paisjeve elektrike brënda dhe jashtë vendit si më poshtë:

| Pershkrimi | 2018 | 2017 |
|---|---|---|
| Te ardhura nga shitja e mallrave | 1,147,577,169 | 997,384,793 |
| **Total** | **1,147,577,169** | **997,384,793** |

### *11.2 Të Ardhura të Tjera*

Në të Ardhurat e tjera paraqiten :

| Pershkrimi | 2018 | 2017 |
|---|---|---|
| Të ardhurat nga bonuset e furnitorëve | 28,816,595 | 27,444,441 |
| Te ardhura nga shitja e AAM | 2,791,951 | 1,066,035 |
| **Total** | **31,608,546** | **28,510,476** |

### *11.3 Mallrat, Lëndët e para dhe Shërbimet*

Paraqet koston totale të blerjes së mallrave të shitura të llogaritur si vijon:

| KOSTO E MALLRAVE TË SHITURA | Viti 2018 | Viti 2017 |
|---|---|---|
| Blerjet gjatë ushtrimit | 879,737,078 | 858,312,093 |
| Ndryshimi i gjëndjeve se mallrave (+/ -) | -37,695,798 | -71,835,631 |
| **TOTALI** | **842,041,280** | **786,476,462** |

### *11.4 Shpenzime të Personelit*

Shpenzimet e personelit paraqiten si më poshtë:

| Pershkrimi | 2018 | 2017 |
|---|---|---|
| Shpenzime per paga | 67,264,742 | 60,200,105 |
| Shpenzimet e sigurimeve shoqerore e shendetsore | 9,616,175 | 8,885,581 |
| **Total** | **76,880,917** | **69,085,686** |

Në Shpenzimet për personelin, janë përfshirë shpenzimet për paga, shpërblime dhe Sigurime Shoqërore e Shëndetsore të punonjësve të Shoqërisë gjatë vitit 2018.
Shoqëria për punonjësit e saj, ka llogaritur, deklaruar dhe paguar në përputhje me kërkesat ligjore, Tatimin mbi pagat, kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetsore.

### *11.5 Shpenzime të Tjera nga Veprimtaritë e Shfrytëzimit*

Në këtë zë janë përfshirë shpenzimet e tjera të aktivitetit kryesorë të shoqërisë. Përbërja e tyre jepet në tabelën në vijim:

| SHPENZIME TË TJERA NGA VEPRIMTARITË E SHFRYTËZIMIT | Viti 2018 | Viti 2017 |
|---|---|---|
| Furnitura nëntrajtime e shërbime | 98,226,361 | 61,460,135 |
| Shpenzime për taksa | 1,260,365 | 1,116,198 |
| Shpenzime të tjera rrjedhëse | 9,010,670 | 8,256,262 |
| Vlera kontabël e AAM të shitura | 3,388,375 | 1,613,144 |
| **TOTALI** | **111,885,771** | **72,445,740** |

*(i) Furnitura, Nëntrajtime dhe Shërbime*

Në Shpenzime për furnitura, nëntrajtime dhe shërbime janë përfshirë disa zëra shpenzimesh që janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

| FURNITURA, NËNTRAJTIME DHE SHËRBIME | Viti 2018 | Viti 2017 |
|---|---|---|
| Energji elektrike, ujë | 8,492,946 | 8,165,087 |
| Blerje të ndryshme | 24,672,759 | 1,608,546 |
| Qera | 38,017,640 | 27,997,640 |
| Riparime të ndryshme | 5,991,617 | 4,388,858 |
| Prime të sigurimit | 3,547,044 | 1,894,622 |
| Shërbime të ndryshme | 9,063,204 | 10,272,028 |
| Reklama, njoftime | 79,506 | - |
| Dieta, udhëtime | 3,434,070 | 3,232,284 |
| Shpenzime postare, telekomunikacion | 1,844,900 | 1,847,667 |
| Transport për shitje | 1,992,224 | 664,807 |
| Shërbime - komisione bankare, | 1,090,450 | 1,388,596 |
| **TOTALI** | **98,226,361** | **61,460,135** |

*(ii) Shpenzime për Tatime dhe Taksa*

Në këto shpenzime janë përfshirë pagesat si në tabelën e mëposhtme:

| SHPENZIME PËR TATIME DHE TAKSA | Viti 2018 | Viti 2017 |
|---|---|---|
| Taksa-tarifa vendore | 625,925 | 573,000 |
| Taksë regjistrimi | 122,108 | 208,132 |
| Taksa të ndryshme, pulle,Qkr,leje qark. | 74,327 | 68,490 |
| Taksë kolaudimi | 264,304 | 145,360 |
| Taksë peshe, disvolta, etj | 173,701 | 121,217 |
| **TOTALI** | **1,260,365** | **1,116,198** |

Shpenzimet për taksat doganore, akciza dhe taksa skanimi për vitin 2018, nuk paraqiten në këtë zë pasi ato janë përfshirë në koston e blerjeve të mallrave (*shënimi 11.3*).

*(iii) Shpenzime të tjera*

Në shpenzimet e tjera janë përfshirë shpenzimet që pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:.

| SHPENZIME TË TJERA RRJEDHËSE | Viti 2018 | Viti 2017 |
|---|---|---|
| Subvencione e ndihma të dhëna | 271,748 | 323,236 |
| Shpenzime përfaqësimi | 7,563,243 | 5,842,352 |
| Penalitete, gjoba | 17,472 | 913,554 |
| Të tjera të panjohura | 1,158,207 | 1,177,119 |
| **TOTALI** | **9,010,670** | **8,256,262** |

*(iv) Vlera Kontabël e AAM të nxjerra e të shitura*

Në këtë zë të Shpenzimeve për vitin 2018 paraqitet vlera kontabël e AAM-ve të shitura gjatë vitit.

### *11.6 Të Ardhura dhe Shpenzime për interesa*

Në zërin të Ardhura dhe Shpenzime për interesa janë përfshirë diferencat ndërmjet të Ardhurave dhe Shpenzimeve për interesat. Paraqitja si vijon:

| Pershkrimi | | 2018 | 2017 |
|---|---|---|---|
| | Te Ardhura nga Interesi | 8,486 | 64 |
| | Shpenzime nga Interesi | (5,435,369) | (5,544,116) |
| | **Total** | **(5,426,883)** | **(5,544,052)** |

### *11.7 Fitimet dhe humbjet nga kursi i kembimit*

Në këtë zë të shpenzimeve paraqiten fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit për transsaksione të ndodhura gjatë vitit 2018, dhe për tepricat e llogarive në datë 31.12.2018. Paraqitja e tyre jepet si në tabelë:

| **Pershkrimi** | 2018 | 2017 |
|---|---|---|
| *Fitimi nga Kurset e kembimit* | 36,310,580 | 13,665,990 |
| *Humbje nga Kurset e kembimit* | -7,008,678 | -9,157,623 |
| **Total** | **29,301,902** | **4,508,367** |

## 12. Fitimi

Shoqëria ka rezultuar me një Fitim Kontabël para tatimit prej 161,252,085 lek dhe me Fitim pas tatimit mbi fitimin prej 136,269,844 lek. Shoqëria ka llogaritur një Tatim mbi fitimin prej 24,982,241 lek.

Për llogaritjen e Tatimit mbi fitimin të vitit 2018 Shoqëria ka bërë rregullimet e nevojshme fiskale, duke konsideruar si të panjohura për qëllime fiskale një sërë Shpenzimesh. Fitimi i tatueshëm i Shoqërisë për vitin 2018 rezulton 166,548,276 lek.

Llogaritja e Shpenzimeve të panjohura, e Fitimit të tatueshëm dhe e Tatimit mbi fitimin për vitin 2018 paraqitet si më poshtë:

| **Pasqyra e rezultatit tatimor 2018** | | **Viti 2018** |
|---|---|---|
| **Fitimi/Humbja e vitit 2018** | | 161,252,085 |
| **Korigjimet e rezultatit sipas ligjit tatimor:** | | |
| *Shpenzime të tjera* | *1,158,207* | |
| *Gjoba Penalitete e te ngjashme* | *17,472* | |
| *Shpenzime Pritje Percjellje* | *4,120,511* | |
| **Totali i shpenzimeve të panjohura** | | **5,296,191** |
| **Fitimi/Humbja i tatueshem para mbartjes se humbjes fiskale** | | 166,548,276 |
| Humbja fiskale nga viti | | |
| Fitimi/Humbja fiskale e vitit | | 166,548,276 |
| Norma e tatimit aktual mbi fitimin | | 15% |
| Tatimi aktual mbi fitimin | | 24,982,241 |
| **Shpenzimi kontabel i tatimit mbi fitimin** | | **13,697,875** |

## 13. Transaksionet me Palët e Lidhura

Sipas statutit të shoqërisë, organi më i lartë vendimmarrës është asambleja e ortakëve. Shoqëria drejtohet nga administratori i saj.

Gjatë vitit 2018 transaksioinet me palët e lidhura konsistojnë në huan e marrë nga ortakët e saj, si dhe llogaritja për interesat lidhur me këto hua. Një paraqitje e këtyre transaksioneve dhe tepricave të tyre në fund jepet si më poshtë:

### 13. Transaksionet me Palët e Lidhura - vazhdim

#### Tepricat ne Bilanc 31.12.2018

| Pershkrimi | 2018 | 2017 |
|---|---|---|
| Hua afat-shkurter nga ortaku | 0 | 2,260,150 |
| Detyrime te tjera –Interesa te llogaritura | 635,550 | 868,300 |
| Huamarrje afatgjate nga ortaket | 29,620,800 | 31,908,000 |
| **Total** | **30,256,350** | **35,036,450** |

#### Pasqyra e Te ardhurave dhe shpenzimeve

| **Pershkrimi** | 2018 | 2017 |
|---|---|---|
| Shpenzime per interesa | 748,234 | 1,021,530 |
| **Total** | **748,234** | **1,021,530** |

## 14. Ngjarjet mbas datës së bilancit

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së bilancit që do të ishte e nevojshme që të paraqiteshin si rregullime ose informacione shtesë në këto pasqyra financiare.